

STATUT
I
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT
RRUGOR

(DPSHTRR)

KREU I
THEMELIMI, OBJEKTI, EMËRTIMI, VULA, KOHËZGJATJA

Neni 1
Statuti i DPSHTRR

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor si institucion shtetëror, është person juridik, publik, jobuxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për transportet, e krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 21.07.1999 "Për krijimin e DPSHTRR-së".

Neni 2
Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj drejtorie është shërbimi ndaj subjekteve fizike dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor për:

- a) Regjistrimin e mjeteve (pajisjen e tyre me targa, leje qarkullimi, regjistrimin e pronarëve të tyre, pajisjen me certifikatën e errësimit të xhamave, licencimin dhe certifikimin e mjeteve etj.), lëshimin e certifikatës së njohjes, pajisjen me targë Retro për koleksion dhe targë Retro për mjet, si dhe lëshimin e autorizimit të lëvizjes për mjetet e hershme dhe me karakter historik (RETRO), kryerjen e procedurave ligjore për ndryshimin e pronësisë së mjeteve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- b) Monitorimin e kualifikimit të drejtuesve të mjeteve rrugore dhe pajisjen e tyre me leje drejtimi, si dhe përmirësimin e kapacitetit institucional dhe njerëzor në fushën e sigurisë rrugore;
- c) Kontrollin teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore, nëse me ligj nuk është vendosur ndryshe;
- d) Krijimin e regjistrit elektronik kombëtar të mjeteve dhe drejtuesve të tyre, si dhe transmetimin e të dhënave që kërkohen nga organet e përcaktuara me ligj;
- e) Kryerjen e veprimtarisë së agentit tatimor, sipas përcaktimeve ligjore;
- f) Dhënien e lejeve të veprimtarisë së autoshkollave, dëshmitë e taksistit, instruktorëve të praktikës, teorisë etj.;
- g) Trajnimin e specializuar në fushat e transportit rrugor, për pajisjen e aplikantëve me dëshminë e aftësisë profesionale;

- h) Mbikëqyrjen e kualifikuar dhe zhvillimin e zgjidhjeve të integruara për administrimin, si dhe monitorimin e operatorëve të transportit rrugor, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre;
- i) Çdo objekt tjetër veprimtarie në shërbimin e transportit rrugor të lejuar nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi;
- j) Kryerjen e veprimtarisë së agjentit në sigurime, sipas përcaktimeve ligjore;
- k) Kryerjen e veprimtarisë së agjentit për arkëtimin e masave administrative, të vendosura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe policisë së shtetit, sipas akt marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve dhe përcaktimeve ligjore në fuqi;
- l) Zhvillimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete dhe panaire sipas objektit të veprimtarisë së DPSHTRR-së.

Neni 3 **Emri, Qendra, Organizimi**

1. Emri i këtij institucioni është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe emërtimi i shkurtuar është DPSHTRR;
2. Qendra e DPSHTRR gjendet në Tiranë;
3. DPSHTRR-ja ushtron veprimtarinë e saj si drejtori shërbimesh në të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet krijimit të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe Drejtorinë e Targave e Shtypshkrimeve të strukturuar në degë, sektorë e zyra në varësi të tyre;
4. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e DPSHTRR-së rregullohen në përputhje me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës dhe të akteve të tjera nënligjore, në zbatim të tij.

Neni 4 **Vula**

DPSHTRR ka vulën e saj, e cila është në formë të rrumbullakët. Në gjysmëharkun e sipërm shkruan “Republika e Shqipërisë” dhe “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor”, kurse në gjysmëharkun e poshtëm shkruan "Ministrinë përgjegjëse për transportin rrugor". Në qendër të vulës është Stema Zyrtare e Republikës së Shqipërisë dhe sipër saj, shkurtimi “DPSHTRR”.

Neni 5 **Kohëzgjatja**

DPSHTRR krijohet për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon fushën e transportit rrugor, si dhe me këtë statut, për një afat kohor të pacaktuar.

KREU II **DREJTIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI**

Neni 6

Ministri

Ministri përgjegjës për transportin rrugor ushtron këto kompetenca në raport me DPSHTRR-në:

- a) Miraton dhe drejton politikat në fushën e Shërbimit të Transportit Rrugor;
- b) Miraton Programet Ekonomike Financiare vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- c) Miraton tarifat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- d) Emëron anëtarët e Këshillit Drejtues;
- e) I propozon Kryeministrit, Drejtorin e Përgjithshëm të DPSHTRR-së;
- f) Emëron dhe liron nga detyra Zëvendësdyrektoret e Përgjithshëm me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm;
- g) Miraton organigramën dhe strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- h) Miraton strukturën e pagave të punës dhe shpërblimet e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- i) Miraton statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- j) Emëron audituesit ligjor për auditimin ligjor të llogarive vjetore.

Neni 7

Organet Drejtuese

Organet drejtuese të DPSHTRR-së janë:

- a) Këshilli Drejtues;
- b) Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 8

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë që emërohen nga Ministri. Ministri cakton Kryetarin e Këshillit Drejtues. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote;
2. Këshilli Drejtues emëron një sekretar që është përgjegjës për organizimin e mbledhjeve, mbajtjen e procesverbaleve, zbardhjen e vendimeve, njoftimin e mbledhjes, si dhe për realizimin e komunikimeve të anëtarëve. Protokollimi i vendimeve dhe procesverbaleve zyrtarizohet në DPSHTRR. Sekretar i Këshillit Drejtues zgjidhet një punonjës nga personeli i DPSHTRR-së me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm;
3. Pagesa e Këshillit Drejtues është mujore dhe do të bëhet si më poshtë:
 - a. Kryetari do të paguhet me 30 % të pagesës bruto të Drejtorit të Përgjithshëm;
 - b. Anëtarët do të paguhet me 20 % të pagesës bruto të Drejtorit të Përgjithshëm;

- c. Sekretari do të paguhet me 10% të pagesës bruto të Drejtorit të Përgjithshëm.
4. Në emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues, respektohen papajtueshmëritë për shkak të detyrave funksionale apo ndalesat ligjore në fuqi;
 5. Funksioni i anëtarit të Këshillit Drejtues zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtë përsëritje dhe përfundon me mbarimin e këtij afati ose me largimin e tij me vendim të Ministrit.

Neni 9

Mbledhja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues si organ kolegjal ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të DPSHTRR-së;
2. Ai është përgjegjës për vendimet që kanë lidhje me çështjet financiare (buxhetin, infrastrukturën, pagat, etj.) në mënyrë që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të DPSHTRR-së në përputhje me objektivat e saj;
3. Mbledhja e Këshillit Drejtues thirret nga Kryetari me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm ose me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të tij;
4. Kryetari miraton rendin e ditës mbi bazën e materialeve të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR-së;
5. Rendi i ditës së mbledhjes së Këshillit duhet të ketë përmbajtjen si në vijim:
 - Vendin e takimit
 - Kohën e takimit
 - Temat që do të diskutohen
6. Nuk duhet të ngarkohet rendi i ditës dhe temat që nuk janë urgjente mund të shtyhen për takimin e radhës, e sidomos nëse për atë temë ka nevojë për detaje më të hollësishme;
7. Këshilli Drejtues mbledhet sa herë e vlerëson që është e nevojshme, por si rregull jo më pak se katër herë në vit;
8. Gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues mbahet procesverbal, i cili duhet të ofrojë përmbajtje të qartë për vendimet dhe veprimet e marra nga anëtarët gjatë takimit dhe nënshkrimin e tyre;
9. Këshilli Drejtues shqyrton dhe merr vendime me shumicë votash.

Neni 10

Kompetencat e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues ka këto kompetenca:

- a) Miraton krijimin, shkrirjen, bashkimin ose ndarjen e Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe strukturave të barasvlershme me to, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm;
- b) Miraton nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, me qëllim rritjen apo përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga DPSHTRR;

- c) Miraton me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm kriteret e përgjithshme për nivelin arsimor, llojin e arsimit, pagat e punës për çdo pozicion pune dhe shpërblimet e punonjësve sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- d) Miraton strukturën e pagave të punës, nivelin e pagave, rritjen e tyre, si dhe shpërblimet e punonjësve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat ja propozon për miratim përfundimtar Ministrit përgjegjës për transportet;
- e) Miraton paraprakisht organigramën dhe strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila paraqitet për miratim përfundimtar tek Ministri përgjegjës për transportet;
- f) Miraton çdo akt juridik që krijon, njeh, ndryshon ose pushon të drejta pronësie mbi pasuritë e paluajtshme (shitblerjen, dhënien e marrjen me qira, të drejta uzufrukti, servituti, enfiteozë, etj.) dhe për rastet e parashikuara në legjislacionin në fuqi, të cilat ja propozon për miratim përfundimtar Ministrit përgjegjës për transportin rrugor;
- g) Miraton lidhjen e kontratave të huadhënies dhe huamarrjes në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar;
- h) Miraton me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve;
- i) Miraton kriteret e shpërndarjes nga Drejtori i Përgjithshëm të fondit për ndihmën sociale dhe të fondeve të tjera;
- j) Miraton llogaritë vjetore dhe raportin vjetor të veprimtarisë ekonomike, si dhe shpërndarjen e fitimeve neto të DPSHTRR-së;
- k) Miraton paraprakisht Programin Ekonomiko Financiar të vitit pasardhës dhe programin afatmesëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, të cilat ia propozon për miratim përfundimtar Ministrit përgjegjës për transportin rrugor;
- l) Miraton ndryshimet brenda totalit të zërave të investimeve të Programit Ekonomiko Financiar të miratuar nga Ministri përgjegjës për transportet, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm;
- m) Miraton Rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit;
- n) Miraton tarifatat e shërbimeve dhe ia propozon Ministrit përgjegjës për transportin rrugor, për konfirmim;
- o) Miraton anëtarësimin në fondin e pensioneve vullnetare, si dhe sigurimin e shëndetit në punë të punonjësve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- p) Raporton me shkrim Ministrit përgjegjës për transportin rrugor, një herë në gjashtë muaj për ecurinë e DPSHTRR-së;
- q) Miraton me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të quajtura sponsorizime, të veprimtarive sociale e publike sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 11 Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit përgjegjës për transportin rrugor;
2. Drejtori i Përgjithshëm duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
 - b) Të ketë mbaruar arsimin e lartë me nivel diplomimi të barasvlershëm me master shkencor në degët: ekonomik, juridik, inxhinieri, administrim publik, shkenca politike, informatike, me përvojë pune në profesion jo me pak se 7 (shtatë) vjet;
 - c) Ose ka mbaruar çdo arsim të lartë me nivel diplomimi të barasvlershëm me master shkencor, kur ka dhe përvojë pune në nivele drejtuese të larta në administratën publike qendrore ose vendore, në total jo me pak se 7 (shtatë) vjet;
 - d) Të mos jetë dënuar asnjëherë penalisht dhe nuk është shkarkuar asnjëherë nga organi titullar me motivacion për shkelje në ushtrimin e detyrës.
3. Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet nga detyra në rastet kur:
- a) Kryen veprime në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi;
 - b) Nuk realizon objektivat e përcaktuara në programet e miratuara nga Këshilli Drejtues;
 - c) DPSHTRR, në bazë të buxhetit të miratuar vjetor, nuk përballon nivelin e shpenzimeve të veprimtarisë së përditshme për 3 vjet me radhë;
 - d) Dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
 - e) Bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht për të kryer detyrat e tij;
 - f) Dëmton imazhin, interesat ekonomike, si dhe misionin për shërbimin publik të DPSHTRR-së;
 - g) Mungon pa arsye në detyrë dhe refuzon të përmbushë detyrimet statutores e administrative.
4. Drejtori i Përgjithshëm ushtron detyrat në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj, statut ose që i caktohen nga Këshilli Drejtues në përmbushje të detyrave të tij;
5. Veprimtaria e DPSHTRR-së drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe në mungesë të tij nga Zëvendës drejtori i Përgjithshëm që delegohet zyrtarisht;
6. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Ministri përgjegjës për transportin rrugor, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 12

Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm ushtron këto detyra kryesore:

- a) Përfaqëson DPSHTRR-në, në marrëdhënie me të tretët, me kompetenca të plota, në kufijtë e objektit të saj, me përjashtim të kompetencave që Statuti ia ka caktuar shprehimisht Këshillit Drejtues;
- b) Nënshkruan marrëveshje me persona fizik, juridike, publike apo private, organizata jofitimprurëse, me synim rritjen e konsolidimit ekonomik të DPSHTRR-së, përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara nga DPSHTRR-ja, si dhe mbrojtjen e interesit të publikut që ndikohet nga këto shërbime në administrimin e DPSHTRR-së;
- c) I propozon Ministrin përgjegjës për transportin rrugor, emërimin dhe lirimin nga detyra të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm;

- d) Emëron dhe liron nga detyra të gjithë punonjësit e DPSHTRR-së, të gjithë punonjësit e drejtorive rajonale, si dhe të barasvlershme me to në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- e) Komandon në detyrë punonjës të DPSHTRR-së, të drejtorive rajonale, si dhe të atyre të barasvlershme me to, për funksione pozicione të lira ose funksione e detyra provizore;
- f) Vendos për dhënie mase disiplinore për të gjithë punonjësit e institucionit, ndërsa për Zëvendës drejtorin e Përgjithshëm informon Ministrin përgjegjës përpara çdo mase disiplinore;
- g) Kryen detyrat si “Nëpunës i autorizuar” në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- h) Përgjigjet dhe kryen detyra të Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësinë publike duke ngritur struktura për zbatimin e përmbushjen e detyrave;
- i) Administron shpenzimet, si dhe miraton ndryshimet e zërave brenda totalit të shpenzimeve. Detajon zërat e investimeve të lëna në kompetencën e tij nga Këshilli Drejtues, sipas kërkesave të Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtorive rajonale, brenda totalit të tyre në Programin Ekonomiko Financiar, të miratuar nga Ministri përgjegjës për transportet;
- j) Raporton me shkrim ose me gojë sipas kërkesës, përpara Ministrit përgjegjës për transportin rrugor për veprimtarinë e DPSHTRR-së;
- k) Ndjek dhe kontrollon zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e DPSHTRR-së;
- l) I propozon Ministrit përgjegjës për transportin rrugor draft politika, sugjerime zyrtare, studime ose informacione të vlefshme në proces të hartimit të reformave ose politikave të reja për sektorin e shërbimeve të transportit rrugor dhe legjislacionit që ndikon ose në funksion të projekteve ndërsektoriale e ndërministrore ose konventave ndërkombëtare;
- m) Miraton përshkrimin dhe planet e punës të gjithë punonjësve në varësi të tij;
- n) I propozon Këshillit Drejtues, vendimmarrja e të cilit i kalon për miratim përfundimtar Ministrit përgjegjës për transportin rrugor:
 - Organigramën e DPSHTRR-së, drejtorive rajonale, si dhe të barasvlershme me to;
 - Tarifat për kryerjen e shërbimeve nga DPSHTRR-ja;
 - Programin Ekonomiko Financiar të vitit pasardhës;
 - Kriteret e përgjithshme për nivelin arsimor, llojin e arsimit, pagat e punës për çdo pozicion pune dhe shpërblimet e punonjësve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - Raporton me shkrim pranë Këshillit Drejtues, një herë në gjashtë muaj për ecurinë e treguesve ekonomik financiar të DPSHTRR-së.
- o) Nxjerr urdhra në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për administrimin dhe drejtimin sipas objektit të veprimtarisë që ushtron DPSHTRR-ja;
- p) Përcakton çmimet e mallrave apo shërbimeve, në bazë të kërkesës dhe ofertës me përjashtim të atyre rasteve që përcaktohen me dispozita të veçanta;
- q) Miraton rregullore dhe procedura teknike e financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas objektit të veprimtarisë së DPSHTRR-së.

Neni 13
Kufizimet e Drejtorit të Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Drejtues të DPSHTRR-së;
2. Detyrat që i cakton ligji dhe ky statut Këshillit Drejtues, nuk mund t'i delegohen Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 14
Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorët

1. Drejtori i Përgjithshëm mbështetet në punën e tij për arritjen e objektivave të DPSHTRR-së nga dy Zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm, që mund të koordinojnë njëkohësisht disa sektorë ose mund të ndjekin me operativitet ecuri të ndryshme projektesh multisektoriale;
2. Zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm dhe drejtorë të drejtorive në DPSHTRR, mund të emërohen personat që plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) Të jenë shtetas shqiptar;
 - b) Të kenë mbaruar arsimin e lartë me nivel diplomimi të barasvlershëm me master shkencor;
 - c) Të kenë përvojë në punë në profesionin e tyre jo më pak se 5 (pesë) vjet;
 - d) Të mos jenë dënuar penalisht.
3. Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm emërohen dhe lirohen nga detyra nga Ministri përgjegjës për transportin rrugor, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.
4. Kompetencat dhe nivele arsimimi të detajuara të Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm, Drejtorëve në DPSHTRR, drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Drejtoritë Rajonale dhe të gjithë personelit përcaktohen në rregulloren e brendshme të DPSHTRR-së.

KREU III
KONTABILITETI, GJENDJA FINANCIARE, PËRDORIMI I FITIMIT

Neni 15
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i DPSHTRR-së përbëhet nga:

- a) Kapitali në momentin e krijimit të DPSHTRR-së, mbi bazën e bilancit të audituar, nga ekspertët kontabël në fund të vitit 1999;
- b) Fondet (Rezervat).

Neni 16
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i DPSHTRR-së mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 17

Kontabiliteti, inventari, gjendja financiare

1. Veprimtaria financiare kryhet në zbatim të ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit. DPSHTRR mban kontabilitetin e saj në pajtim me ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
2. Në mbyllje të çdo viti financiar, por jo me vonë se 3 (tre) muaj nga data e mbylljes së vitit, DPSHTRR përgatit bilancin përmbledhës financiar për efekte fiskale, sipas bilanceve verifikuese të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
3. Viti financiar, në të cilën përgatiten dhe publikohen gjendjet financiare të DPSHTRR-së, fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 18

Rezultati financiar

Rezultati financiar i DPSHTRR-së përcaktohet në mbyllje të çdo viti, si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Fitimi neto përcaktohet pasi të zbritet tatimi mbi fitimin i llogaritur në mënyrë të përqendruar për DPSHTRR-në , sipas akteve ligjore dhe nënligjore të saj.

Neni 19

Ndarja e fitimit neto

Fitimi neto shpërndahet si vijon:

Për krijimin e rezervës së kapitalit në masën 5% të fitimit vjetor neto, por jo më pak se një e dhjeta e shumës së kapitalit.

- a) Për krijimin e rezervës për zhvillim;
- b) Për krijimin e rezervës për ndihma sociale në masën 5% të fitimit vjetor neto;
- c) Për krijimin e rezervës për shpërblim suplementar të punonjësve në masën 15% të fitimit vjetor neto, e cila shpërndahet çdo vit në fund të gjashtë mujorit të parë dhe në fund të gjashtë mujorit të dytë në masën sa dy paga mujore për secilin punonjës për çdo vit;
- d) Për krijimin e rezervave të tjera në masën 5% të fitimit vjetor neto;
- e) Në fund të vitit ushtrimor, pjesa e papërdorur e rezervës për ndihma sociale dhe rezervave të tjera kalojnë në rezerva për zhvillim.

Bazuar në performancën financiare të DPSHTRR-së, Ministri përgjegjës për transportin rrugor, me përjashtim të rezervës ligjore, urdhëron derdhjen në buxhetin e shtetit të një pjesë të rezervave të tepërta të krijuara nga fitimet e viteve të kaluara, të cilat nuk janë përdorur, por jo më shumë se 25% të tyre.

Neni 20

Auditimi ligjor i llogarive

Ekspertimi ligjor i llogarive vjetore kryhet nga audituesit ligjore, të cilët caktohen për një periudhë 4- vjeçare nga Ministri përgjegjës për transportin rrugor ndërmjet listës së autorizuar nga ligji.

Shpërblimi i audituesve ligjor bëhet sipas akteve ligjore në fuqi.

Pasqyrat financiare të çdo viti financiar miratohen nga audituesit ligjore, brenda datës 30 Maj të vitit pasardhës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pasqyrat e miratuara depozitohen në organet tatimore dhe Ministrinë përgjegjëse për transportin rrugor, përfshirë edhe vërejtjet e audituesit ligjor nëse ka të tilla.

KREU VI

DREJTORITË RAJONALE

Neni 21

Statusi i Drejtorive Rajonale

Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe ato të barasvlershme me to, janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe janë pjesë përbërëse e strukturës së saj.

Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor kanë emërtimin e tyre të shkurtuar (DRSHTRR) dhe krijohen në bazë rajoni dhe kanë varësi degë, sektorë dhe zyra shërbimi. DRSHTRR-të kryejnë shërbime të përcaktuara në objektin e veprimtarisë sipas nenit 2 të këtij Statuti.

Neni 22

Drejtimi i DRSHTRR

Drejtimi dhe administrimi i Drejtorive Rajonale ushtrohet nga Drejtori i saj, i cili përgjigjet për të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzimet, urdhrat, aktet administrative të DPSHTRR-së dhe nenet e këtij Statuti.

Drejtorja Rajonale ka vulën e saj.

Neni 23

Raportimet e DRSHTRR

Drejtoritë Rajonale dërgojnë pranë DPSHTRR-së në afatet e përcaktuara dhe sa herë kërkohet, të dhëna periodike, evidenca statistikore, bilancin verifikues me relacion shoqërues, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.

Drejtoritë Rajonale kryejnë analiza ekonomike financiare të plota dhe pjesore dhe informojnë DPSHTRR-në për problemet që konstatohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë.

Neni 24
Detyrimi për të ruajtur sekretin dhe etikën pas largimit nga detyra

Anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, si dhe të gjithë personat e punësuar në DPSHTRR, janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e çdo informacioni që marrin gjatë kryerjes së detyrave dhe të mos e përdorin atë për përfitime personale apo për të tretë, si gjatë kohës që janë në funksion ashtu edhe pas largimit të tyre.

Pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, Anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, si dhe të gjithë personat e punësuar në DPSHTRR dhe personat e lidhur direkt me ta (bashkëshorti/ja dhe prindërit përkatës, fëmijë të pamartuar, bashkëshorti/ja e fëmijës së martuar) ndalohen të bëjnë konkurrencë, të rezultojnë aksionerë, ortakë apo të formojnë, zotërojnë dhe të drejtojnë shoqëri/sipërmarrje konkurrentë me objekt veprimtarie aktivitetin që kryen DPSHTRR. Shkelja e këtij detyrimi i ngarkon ata me përgjegjësi ligjore civile ose penale.

Neni 25
Përgjegjësia e DPSHTRR-së

DPSHTRR është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga organet e saj gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

DPSHTRR përgjigjet për detyrimet e saj brenda kufijve të pasurisë së saj.

Personat që kanë vepruar me cilësinë e organit të personit juridik, kanë përgjegjësi vetjake për shpërblimin e dëmeve që janë shkaktuar për fajin e tyre.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Statuti i miratuar me urdhrin e Ministrit nr. 123, datë 20.10.2017, i ndryshuar me urdhër nr. 780, datë 06.11.2018 dhe urdhër nr. 780/2, datë 19.11.2018, shfuqizohet.

Ndryshuar me shkresën e Ministrit nr. 4572/1 prot., datë 21.12.2022 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në statutin e DPSHTRR”, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ndryshuar me shkresën e Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3774/1 prot., datë 22.07.2026 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në statutin e DPSHTRR-së”, protokolluar në DPSHTRR me nr. 9214/2 prot., datë 24.07.2026.

MIRATOHET MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË